REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 7418/6 Prot

Divjakë, më. 16 /09/2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. 84 Datë, 16 /09/2026

"PËR MIRATIMIN E SHTESËS SË NEVOJAVE BUXHETORE TË SHOQËRISË RRJELA SHPK"

Në mbështetje të nenit 23, nenit 25, nenit 33, pika 3, nenit 34, nenit 40 dhe nenit 54, shkronja "dh", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar; të Vendimit të Këshillit Bashkiak Divjakë nr. 85, datë 29.12.2025, "Për transferimin e disa funksioneve nga aparati i Bashkisë Divjakë në shoqërinë "Rrjela" SHPK"; si dhe të kërkesës për nevoja buxhetore të paraqitur nga shoqëria "Rrjela" SHPK për miratim nga ortaku i vetëm, me nr. 7426 prot., datë 09.09.2026, i propozojme këshillit të Bashkisë Divjakë, në mbledhjen e datës 25 /09/2026,

TË MIRATOJË;

Mbështetjen financiare për shoqërinë "RRJELA" SHPK, në shumën totale prej 13,200,000 lekësh"sipas kërkesës së shoqërisë, si më poshtë:

- 9,700,000 lekë për blerjen e një SHREDDERI, për menaxhimin e mbetjeve të gjelbra
- 3,500,000 lekë për aktivitete festive dhe komunitare të fundvitit 2026.

Detyrimet e SHPK-së

Rrjela SHPK është e detyruar të:

a)përdorë fondet vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë vendim
b)Përgatisë dhe dorëzojë raporte (3 mujore) ose vetëm një raport vjetor
c)Të kthejë çdo shumë të pashrytëzuar sipas udhëzimeve të bashkisë
d)Mbajë dokumentacion të detajuar të të gjiha shpenzimeve dhe pagesave për çdo aktivitet apo projekt.

Monitorimi dhe raportimi

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Sektori i Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë do të monitorojë përdorimin e fondeve në bazë të raporteve;

Çdo shkelje e kushteve mund të çojë në ndërprerje të fondeve dhe masa ligjore sipas ligjit.

.Afati i përdorimit të fondeve

*Fondet e miratuara në këtë vendim përdoren brenda vitit 2026 dhe sipas afateve të përcaktuara për secilin aktivitet/projekt.

Për ndjekjen e procedures se këtij projekt - vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike Drejtoria e Kulturës ,Sportit , Turizmi dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Për Drejtorinë Juridike
Andi Bullari

Për Drejtorinë e Kulturës ,Sportit dhe Turizmit

Laurent Gjeci

Për Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit

Xheladin Brahkola

KRYETARI

Josif GORREA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIVJAKË